



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më, 25.07.2022 merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2021 NË VITIN 2022.

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022 me nr. 01-401/03-94160/22 i dt. 29.04.2022

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim-ndryshimi nënkupton ridestinimin e mjeteve në vlerë prej **8,544,666.13 €** në kategorinë e investimeve kapitale, shkak i respektimit të strukturës së kategorive ekonomike.

III.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-401/03-177523/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

